



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	26.12.2023	3	viti- god year
Organ /Njësia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Filog Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKM/SHK	7668/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1343/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1221/2023 të datës 29.09.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ankesën me numër A.nr.1232/2023 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ankesën me numër A.nr.1318/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ankesën me numër A.nr.1329/2023 të datës 25.10.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ dhe ankesën me numër A.nr.1343/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ të cilat sipas Vendimit me numër protokolli 7090/2023 të datës 24.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë bashkuar në ankesën e fundit me numër A.nr.1343/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesja Arjana Zhubi, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Hedhet poshtë ankesa me numër A.nr.1329/2023 e datës 25.10.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_
- II. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1221/2023 e datës 29.09.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ankesa me numër A.nr.1232/2023 e datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ ankesa me numër A.nr.1318/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesi Agron \_\_\_\_\_ dhe ankesa me numër A.nr.1343/2023 e datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ të cilat sipas Vendimit me numër protokolli 7090/2023 të datës 24.11.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës janë bashkuar në ankesën e fundit me numër A.nr.1343/2023 të datës 27.10.2023.

III. Anullohet Vendimi me Nr. 1574 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr. 1576 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr.1578 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr. 1581 i datës 28.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit, Raporti i datës 11.09.2023 për Renditjes përfundimtare të kandidatëve dhe Njoftimi i datës 12.09.2023 për kandidatët fitues dhe të gjitha veprimet juridike-procedurale të ndërmarra nga faza e verifikimit paraprak deri ne rezultatet përfundimtare, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme

IV. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e zhvilluar procedurën e pranimit për grupin "*Specialist i Arsimit për pozitën Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovë-katër (4) pozita*", nga faza e verifikimit paraprak.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

### A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 05.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00011612 për grupin *Specialit i Arsimit për pozitën Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovë*, katër pozita, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023.

Në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesit, ndërsa pas përfundimit të procedurës sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 11.09.2023, rezulton se kandidati A.S nga të gjitha fazat është vlerësuar me gjithsej 70.2 pikë, kandidati K.R nga të gjitha fazat është vlerësuar me gjithsej 77.4 pikë, kandidati A.H ka marr gjithsej 80.4 pikë, kandidati G.S nga faza e testit me shkrim dhe jetëshkrimit është vlerësuar me gjithsej 59.6 pikë, ndërsa kandidatja A.Zh nga të gjithsej fazat është vlerësuar me gjithsej 72 pikë, me çka rezulton se nuk janë në mesin e katër (4) kandidatëve me më së shumti pikë.

Ankuesit të pakënaqur me procedurën e vlerësimit, kanë parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit përmes Vendimit me Nr. 1574 të datës 28.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit A.H, përmes Vendimit me Nr. 1576 të datës 28.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit A.S, përmes Vendimit me Nr. 1581 të datës 28.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankuesit K.R dhe përmes Vendimit me Nr.1578 të datës 28.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses A.Zh.

Ankuesit të pakënaqur me vendimin e cekura si më lartë, brenda afateve ligjore kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje gjatë kësaj procedure.

Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke marr parasysh që ankesat e ankuesve bazohen në një gjendje faktike dhe bazë juridike të njëjta apo të ngjashme dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, bazuar në dispozitat ligjor të aplikueshme, më datë 23.11.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 70990/2023 për bashkimin e këtyre ankesave.

Për shkak të kompleksitetit të ankesave, më datë 08.12.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr Vendim me numër protokolli 7379/2023 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendimmarrje të ankesave të bashkuara në ankesën A.nr.1343/2023 të datës

27.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6294/2023 të datës 29.09.2023 e parashtruar nga ankuesi A.S në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit e parashtruar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr. 1576 të datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 08.11.2023; Ankesën me numër protokoll 6309/2023 të datës 02.10.2023 e parashtruar nga ankuesi K.R në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1581 të datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 10.10.2023; Ankesën me numër protokoll 6661/2023 të datës 24.10.2023 e parashtruar nga ankuesi A.R në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Ankesën e datës 15.09.2023 të ankuesit; Vendimin me Nr. 1574 TË datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 01.11.2023; Ankesën me numër protokoll 6682/2023 të datës 25.10.2023 e parashtruar nga ankuesi G.S në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Emailin e datës 13.09.2023, 29.09.2023 nga SIMBNJ për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 30.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 02.11.2023; Kërkesën për informata zyrtare e datës 04.12.2023; Përgjigjen e datës 04.12.2023; Ankesën me numër protokoll 6713/2023 të datës 27.10.2023 e parashtruar nga ankuesja A.Zh në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.11.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 15.11.2023; Konkursin Nr.Reference: RN00011612 për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovës, katër (4) pozita; Vendimin me Nr. 05/151 të datës 12.07.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Arsimit; Listën a aplikantëve; Njoftimin e datës 10.07.2023 për listë të ngushtë; Njoftimin e datës 19.07.2023 për njoftimin për listën e ngushtë përfundimtare; Njoftimin e datës 12.09.2023 lidhur me vlerësimin përfundimtar të kandidatëve; Vendimin me Nr. 1406/1-2023 i datës 11.09.2023 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve përkatësisht për përfundimin e procedurës së konkurrimit; Renditjen përfundimtar të kandidatëve e datës 11.09.2023; Vendimin me Nr. prot: 1010 të datës 20.06.2023 për shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak; Vendimin me Nr. 1576 të datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit; Ankesën e ankuese A.ZH për Ministrinë e Punëve të Brendshme; Aplikacionin me të gjitha dokumentet e dorëzuara të ankuesit A.S, K.R, A.H, G.S dhe A.ZH; Aplikacionin me të gjitha dokumentet e dorëzuara të kandidatëve Sh.B, M.D, A.P dhe N.P; Vendimin me numër protokoll 7090/2023 të datës 23.11.2023 për bashkimin e procedurës/ankesave të nxjerr nga Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për informata zyrtare e datës 17.11.2023 nga A.B për N.C dhe H.B; Përgjigjen e datës 17.11.2023 nga B.G për A.B; Kërkesën për informata zyrtare e datës 04.12.2023 nga A.B për Q.B dhe A.K dhe Përgjigjen e datës 05.12.2023 nga A.K për A.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konteston Njoftimin e kandidatëve të datës 05.05.2023 për vlerësimin e rezultatit përfundimtar.

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 25 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: *"5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual. 6. Ankesa shqyrtohet nga Komisioni i Pranimit dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj. Nëse rishqyrtimi sjell ndryshimin e renditjes zbatohet përshtatshmërisht ky nen i kësaj Rregulloreje",* e në kuptim të kësaj bazë ligjore rrjedhë se ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër një procesi të pranimit në shërbimin civil, parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës së brendshme të ankesës tek organi që ka shpall procedurën e pranimit. Ndërlidhur me këtë, paragrafi 4 i nenit 31 të Rregullores si me lartë shprehimisht thekson se: *Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.1. kandidati i pakënaqur me rezultatet e verifikimit paraprak ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15 të kësaj rregulloreje; 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje, apo 4.3. kandidati është cenuar drejtpërdrejtë nga aktet me të cilat është zgjidhur ankesa e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 15, sipas paragrafit 6 të nenit".*

Andaj, bazuar në dispozitat e mësipërme, rrjedh së ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa shteruar procedurën e ankesës së brendshme këtë e konfirmon edhe Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes emailit të datës 04.12.2023 ku thekson se ankuesi nuk ka parashtruar ankese të brendshme, kështu që në këtë pikëpamje, Kolegji në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton ankesa e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se lënda ku ankuesit janë palë në procedurë, duhet të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë, *sepse:*

Kolegji i Këshillit, konstaton se në konkursin Nr.Reference: RN00011612 për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovës, katër (4) pozita, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;
- Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;
- **Përvoja e punës:** Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës me theks të veçantë përvojë pune në mësimdhënie.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në vazhden e shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesve ndaj këtij procesi dhe shkeljeve procedurale dhe materiale, po ashtu në vazhden e shqyrtimit të kërkesave të përgjithshme formale për pranim në shërbimin civil, dhe të gjitha provave të lëndës veç e veç dhe të gjitha së bashku si tersi, konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme përmes vendimeve të kontestuara me ankesë nga ankuesit ndër të tjera konstatojnë se procesi në këtë procedurë është zhvilluar në pajtim me dispozitat ligjore.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të verifikimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit ka analizuar dispozitat e Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojca Nr.1/6: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, kërkesat e përgjithshme formale janë të përcaktuara si në vijim: *a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, dhe ka ardhur në përfundimin se konkursi i kontestuar nga ankuesi, në parim shpallja dhe kriteret e përcaktuara të tij kanë qenë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të ligjit material të ndërlidhura edhe me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.*

Ndërlidhur me plotësimin të kërkesave të përgjithshme formale të konkursit nga kandidatët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstaton se përveç kërkesave për përgatitje profesionale dhe përvojën e punës si kërkesë e përgjithshme formale, lidhur me kriterin që kandidatët duhet të posedojnë *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës*, Kolegji i Këshillit, vlerëson se licenca duhet të jetë valide apo e vlefshme me rastin e aplikimit respektivisht përzgjedhjes.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit, sipas Njoftimit të datës 12.09.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore, për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovë, janë bërë publikë rezultatet e kandidatëve të suksesshëm në këtë procedurë të rekrutimit, si në vijim: Sh. B me gjithsejtë 86.4 pikë, M.D me gjithsejtë 83.2 pikë, A.P me gjithsejtë 82.46 dhe N.P me 82 pikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe verifikimit nëse kandidatët fitues i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit, gjegjësisht ka analizuar dosjen e kandidates fituese Sh.B, posedon Diplomën me Nr. 545 të datës 12.09.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 27.05.2005 studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore duke marr titullin Profesor i Kimisë, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100008783 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017.

Kandidatja fituese M.D posedon Diplomën me Nr. 713 të datës 10.07.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 26.02.2014 studimet themelore në Fakultetin e Edukimit-Qendra në Gjakovës duke marr titullin Bachelor i Biologji-Kimi , sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënies, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100008379 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017.

Kandidati fitues A.P posedon Diplomën me Nr. 99 të datës 18.03.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 12.11.2005 studimet themelore në Fakultetin e Edukimit (Shkolla e Latë Pedagogjike-Gjakovë) duke marr titullin Bachelor i Historisë-Gjeografisë, posedon Diplomën me Nr. 855 të datës 04.11.2014 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se më datë 28.02.2014 ka mbarur studimet në Fakultetin e

Edukimit-Qendra në Gjakovë duke marr titullin Bachelor i Gjeografisë-Edukatë Qytetare, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100007955 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017.

Kandidati fitues N.P posedon Diplomën me Nr. 227 të datës 02.09.2003 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 11.11.1991 studimet themelore në Fakultetin Filozofik duke marr titullin Profesor i Historisë, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100007934 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017.

Po ashtu sa i përket dosjeve të ankuesve, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi A.S, posedon Diplomën me Nr. 322 të datës 01.04.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 04.04.2006 studimet themelore në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore duke marr titullin Bachelor i Gjeografisë, posedon Diplomën me Nr. 136 të datës 20.12.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se më datë 17.07.2009 ka mbarur studimet në Fakultetin e Edukimit-Qendra në Gjakovë duke marr titullin Bachelor i Programit Fillor, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100021945 të lëshuar më datë 20.03.2015 me vlefshmëri deri më datë 20.03.2020, ankuesi K.R, posedon Diplomën me Nr. 2313 të datës 12.04.2021 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 28.06.2002 studimet themelore në Fakultetin Filozofik duke marr titullin Profesor i Historisë, , sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100009203 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017, ankuesi A.H posedon Diplomën me Nr. 124 të datës 04.12.2008 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 14.07.2008 studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Teknologjisë Informative, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100008148 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017, ankuesi G.S, posedon Diplomën me Nr. 160 të datës 12.01.2010 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 16.12.2008 studimet themelore në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë duke marr titullin Bachelor i Historisë-Gjeografisë, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100007904 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017 dhe ankuesja A.Zh. posedon Diplomën me Nr. 105 të datës 02.08.2011 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 17.07.2009 studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Programit Fillor, posedon Diplomën me Nr. 136 të datës 20.12.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" me të cilën dëshmohet se më datë 17.07.2009 ka mbarur studimet në Fakultetin e Edukimit-Qendra në Gjakovë duke marr titullin Bachelor i Programit Fillor, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100008068 të lëshuar më datë 26.12.2012 me vlefshmëri deri më datë 26.12.2017.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se sipas konkursit të shpallur të datës 05.05.2023 me Nr.Reference: RN00011612 për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovës, katër (4) pozita afati për aplikimi ka qenë nga data 26.05.2023 deri me datë 05.06.2023 nga rrjedh se ndërmjet kësaj periudhe kanë aplikuar edhe kandidatet në këtë procedurë, e si rrjedhojë me rastin e aplikimit rezulton se katër kandidatët me më se shumti pikë e që janë kandidat ftues kanë pasur

Licencën e Mësimdhënësit me afat të skaduar apo të pavlefshme me rastin e aplikimit, kjo vlen edhe për ankuesit.

Tutje, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit konkretisht Ministrja e kësaj ministrie më datë 16.06.2023 ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemimin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie, ku në nenin 13 paragrafi 6 është përcaktuar se: "Licencat e karrierës së mësimdhënësve të lëshuara gjatë viteve 2012-2022, vazhdohen për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në realizimin e procesit të brendshëm të VPM-së", me nenin 14 të këtij udhëzimi është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ 05/2017, ndërsa sipas nenit 15 të këtij udhëzimi, është përcaktuar se: "Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës", si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, me qëllim të sqarimit të rrethanës juridike lidhur me vlerësimin e licencave të mësimdhënësve që ju ka skaduar afati e të cilët janë përfshirë në fazat e mëtejshme të rekrutimit, kemi kërkuar informata zyrtar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se mbi bazë të cilit dokument janë vlerësuar këto licenca, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 05.12.2023 njofton se: Lidhur me pyetjen tuaj se si kemi bërë vlerësimin e licencave të mësimdhënësve të cilëve ju ka skaduar afati, a ka ndonjë dokument nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si ministri përgjegjëse për lëshimin e licencave lidhur me këtë çështje, ju informojmë se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it me nr. 14/2023, për sistemimin e licencave dhe karrierës i cili përcakton: "Licencat e karrierës së mësimdhënësve të lëshuara nga vitet 2012-2022, vazhdohen për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në realizimin e procesit të brendshëm të VPM". Andaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar të gjitha licencat e mësimdhënësve gjatë verifikimit.

Duke marr parasysh këtë rrethanë, më datë 17.11.2023 kemi kërkuar nga përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës informatën nëse Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemimin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mirëpo të njëjtën ditë kemi pranuar informatën zyrtare se "Udhëzimi Administrativ në fjale nuk gjendet i publikuar në ëeb portalin e Gazetës Zyrtare, gjithashtu të gjitha aktet të cilat vijnë për publikim në portalin e Gazetës Zyrtare zakonisht publikohen brenda ditës", andaj nga vlerësimi i dosjeve të kandidatëve dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se nga informata e dhënë nga zyrtarët e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ky udhëzim meqenëse nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë nuk është në fuqi dhe i njëjti nuk ka mundur të prodhojë efekte juridike.

Prandaj, duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: "Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë" Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me rastin e përfshirjes së kandidatëve në listën e ngushtë të cilëve iu ka munguar vlefshmëria e licencave të mësimdhënësit, ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si rrjedhojë procedura e rekrutimit që nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të ligjit material dhe 15 paragrafi 1, 2

dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se akti i goditur nga ankuesi në Këshill, gjegjësisht Vendimi me Nr. 1574 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr. 1576 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr.1578 i datës 28.09.2023, Vendimi me Nr. 1581 i datës 28.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit, janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe depozitave të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase nuk ka vërtetuar drejtë gjendja faktike mbi bazën e provave materiale, andaj këto vendime janë të paligjshme në kuptim të nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se pranimi në shërbimin civil sipas konkursit Nr.Reference: RN00011612 për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Gjakovës, katër (4) pozita, nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me parimet për pranim në shërbimin civil, siç parashihet me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore"*, kështu që si rezultat i shkeljeve të evidentuara, Kolegji i Këshillit ka marr vendim sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, që lëndën t'a kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme nga faza e verifikimit paraprak, duke anuluar Raportin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 11.09.2023 dhe Njoftimin e datës 12.09.2023 të kandidatëve fitues.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.1343/2023, më datë 26/12/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesve,
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.